

343.151:343.132]-021 463

Doc. dr. Qebir Avziu¹

VERSIONET DHE PYETJET E ARTA TË KRIMINALISTIKËS

ВЕРЗИИ И ЗЛАТНИ ПРАШАЊА НА КРИМИНАЛИСТИКАТА

GOLDEN QUESTIONS AND VERSIONS OF CRIMINALISTICS

Abstract

Version or hypotheses in general are judgements which are only supposed as correct. Versions arise in order to construe in the penal case, when it can be explained in many ways. In most of the cases, when the investigators arrive in the crime scene, the perpetrator has taken care to not leave any visible proofs; he has almost destroyed all the visible traces.

Therefore in the beginning of the penal case, the investigators face a great difficulty on the development of the criminal case, who is the perpetrator, how many people have participated, what device is used to execute the act, which is the motive, etc. That is why the one related to these circumstances, knows nothing factual about the penal act, or doesn't know the instruments of the execution, so he attempts to explain them, and to visualize the mechanism of the development of the case, by raising Interpretations.

1. Versionet

Versionet apo hipotezat në përgjithësi janë gjykime për të cila supozohet se janë të sakta. Versionet ngrihen me qëllim të interpretimit të ngjarjes penale, kur ajo mund të shpjegohet në më shumë mënyra. Versionet janë të ngjashme me hipotezën, por hipoteza ngrihet për fenomene apo dukuri shoqërore, kurse versioni për raste individuale, që ka të bëjë me interpretimin dhe sqarimin e veprës penale. Pra kur është në pyetje sqarimi i veprës penale, atëherë ngrihet versioni. Qëllimi i

¹ qebiravziu@gmail.com

ngritjes së versioneve është sqarimi kauzalitetit në mes shkakut dhe pasojës, të sqarohen faktet dhe rrethanat e rëndësishme që kanë lindur me rastin e kryerjes së veprës penale. Në shumicën e rasteve, kur hetuesit arrijnë në vendin e ngjarjes, kryerësi është kujdesur që të mos u lë asnjë provë të dukshme, ai thuhet se i ka asgjësuar të gjitha gjurmët e dukshme. Prandaj në fillim të ngjarjes penale, hetuesi përballet me vështirësi të madhe mbi atë se si është zhvilluar ngjarja penale, kush është kryerësi, sa persona kanë marrë pjesë, me cilin mjet është kryer vepra, cili është motivi etj. Prandaj ai lidhur me këto rrethana, nuk dinë asgjë konkrete rreth veprës penale të kryer ose nuk i njeh mekanizmat e kryerjes, prandaj bën përpjekje që t'i sqaroj ato, e të përfytyrojë mekanizmin e zhvillimit të ngjarjes.

Në vendin tonë, hetimet zhvillohen me një vështirësi të madhe, hetuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se askush nuk do t'i ndihmojë atij, të gjithë personat që e kanë parë ngjarjen shpejt largohen apo ikin nga vendi që të mos thirren në cilësinë e dëshmitarit, por edhe kur thirren, ata refuzojnë të japin deklaratë, duke thënë se nuk kishin parë asgjë nga ngjarja penale dhe nuk e dinë se kush është kryerësi. Vërtet, çdo njëri kur thirret në cilësinë e dëshmitarit, ka ndjesi të keqe, qoftë për shkak të kanosjeve nga kryerësi, qoftë për shkak të brejtjes së ndërgjegjes, që mos bëhet ai shkaktar që dikush të përfundojë me vite në burg. Të gjitha këto rrethana bëjnë që hetimet të jenë një proces tejet i ndërlikuar e i vështirë. Prandaj në fillim hetuesi përballet me deficit të informacioneve, (negentropia), dhe nuk i mbetet asgjë tjetër përveç se të fillojë që ngjarjen ta sqaroj dhe ta interpretoj me anë të fuqisë mendore, duke ngritur *versione*.

Versionet janë mendime apo interpretime logjike mbi zhvillimin e ngjarjes penale dhe autorit të saj, kur ajo mund të sqarohet në më shumë mënyra.² Por duhet të dihet se versionet në kriminalistikë ngrihen vetëm atëherë kur çështja penale mund të shpjegohet në më shumë variante, pra versionet ngrihen vetëm atëherë kur nuk jemi të sigurt se si ka ndodhur ngjarja dhe kush mund të jetë kryerësi i saj. Por sigurisht që këto interpretime nuk mund të jenë të zhveshura nga faktet, por të mbështetura mbi rrethanat faktike dhe gjurmët e gjetura në vendin e ngjarjes.

Fillimisht hetuesi mundohet të sqarojë mënyrën e kryerjes së veprës penale, mekanizmin e veprimit, duke sqaruar episodet e veprimit

² Pavišić, B., (2002), *Uvod u Kriminalistiku*, Zagreb, f.83.

të autorit, pastaj mundohen të jep përgjigje mbi numrin e personave që kanë marrë pjesë në ngjarje, të sqarojë drejtimin nga kanë ardhur dhe nga kanë shkuar, mjetin që kanë përdorur për të kryer veprën penale, motivin e kryerjes dhe në fund të përcaktojnë rrethin e personave të dyshuar që kanë kryer veprën penale.

Pra siç shihet, hetuesi zhvillon një proces të ndërlikuar mendor në mënyrë graduale, shkallë-shkallë, hap pas hapi, që vërtet është një punë e lodhshme dhe e mundimshme mendore. Gjithmonë në fillim të hetimeve, hetuesi duhet të ngritë një numër më të madh versionesh, por ne asnjë mënyrë nuk lejohet që ky numër i versioneve të jetë më pak se dy. Ngritja e një versioni shpeshherë është sikur të mos ngrihet asnjë.³ Nëse eventualisht hetuesi ngritë vetëm një version mbi ngjarjen, atëherë ai rrezikon që kur të mos e zbuloj autorin e vërtetë, sepse versioni i ngritur mund të jetë i gabuar dhe kështu hetimet të marrin drejtim të gabuar. Kjo mund të shpjegohet me një ekspeditë e cila mundohet të pushtojë majën e malit. Nëse tani e gjithë ekspedita shkon vetëm në një rrugë, ata rrezikojnë që kur të mos arrijnë në maje të malit, sepse pikërisht kjo mund të jetë rruga e bllokuar, por nëse ekspedita ndahen në ekipe më të vogla dhe marrin rrugë të ndryshme, atëherë ekziston besueshmëria e madhe që njëra nga grupet do të arrije deri tek objektivi kryesor dhe kështu të pushtohet maja e malit.

E njëjta është edhe me ngritjen e versioneve, nëse ngrihen më tepër, atëherë ekziston mundësia që njëra nga ato të jetë e saktë. Ose për shembull, është vjedhur një shtëpi, me këtë rast hetuesi, ngritë versione se kryerës të mundshëm mund të jenë disa persona që janë në faqefisni të cilët edhe më parë janë të regjistruar në evidencat e policisë si hajdut, pastaj dyshime mbi komshinjtë që po ashtu janë kriminelë, por përjashtojnë mundësinë që kryerës mund të jetë edhe ndonjë nga anëtarët e familjes (djali, nusja). Prandaj në këto raste, hetimet do të shkojnë në drejtim të gabuar dhe kështu kryerësi i vërtetë kurrë nuk do të zbulohet, vetëm për shkak se hetuesi nuk i ka ngritur të gjitha versionet e arsyeshme. Në praktikë ndodh që në fillim të hetimeve, të mos ngrihet versioni i saktë mbi ngjarjen penale, megjithatë më vonë duke grumbulluar prova, shihet se versionet e ngritura kanë qenë të gabuara, andaj ngrihen versionet e reja. Me fjalë të tjera, mund të ndodhë që versionet e ngritura në fillim të çështjes penale të eliminohen dhe në

³ Vodinelić, V., (1984), *Kriminalistika*, Beograd, f.238.

vend të tyre të ngrihen versione tjera, më të besueshme, që do të na shpiten drejtë së vërtetës mbi ngjarjen penale.

Por në rastet kur janë grumbulluar aq shumë prova nga të cilat dukshëm ekziston dyshimi i bazuar dhe shihet qartë se si është zhvilluar ngjarja, kush është kryerësi, atëherë do të ngrihet vetëm një version, kjo është e vërteta mbi ngjarjen, që do të qëndroj edhe në kallëzimin penal si varianti zyrtar i çështjes penale.

Versionet janë të lidhura edhe me dyshimet apo me parimin e skepticizmit. Jo rrallëherë në praktikë, vrasjet maskohen si vetëvrasje apo si vdekje natyrore, prandaj nëse hetuesi në bazë të rrethanave të rastit nuk e ngritë edhe versionin se vdekja mund të jetë jo natyrore por pasojë e një vrasjeje, atëherë kurrë nuk do të zbulohet kryerësi. Ky version mund të ngrihet sidomos tek vdekjet e papritura, prandaj në këto raste hetuesi duhet të jetë shumë i kujdesshëm. Për shembull, një nxënëse e shkollës së fshatit B., derisa luante në oborrin e shkollës, u rrëzua pa ndjenja. Arsimitarët dhe disa fshatarë që punonin aty pranë i shkuan menjëherë në ndihmë fëmijës, por e panë se ajo ishte pa ndjenja jete. Më vonë erdhi edhe ndihma e shpejtë, por u konstatua se fëmija kishte vdekur. Në kokë dhe në trupin e fëmijës nuk u konstatua asnjë dëmtim i jashtëm, kështu që, duke menduar se vdekja ishte për ndonjë shkak të brendshëm të vet organizmit të fëmijës, kufomën e saj e varrosën. Më vonë kur ngjarja u kuptua nga policia dhe prokuroria, u vendos që lidhur me vdekjen e papritur të vajzës të bëheshin hetime. Për këtë, u zhvarros viktima dhe gjatë këqyrjes, në kafkën e kokës nga prapa, u gjet e ngulur një predhë rrafsh me të dhe e mbuluar nga flokët e cila e mbyllte plotësisht vrimën e hyrjes dhe pengonte hemorragjinë. Predha u nxor, dhe nga ekzaminimi kriminalistik rezultoi se i përkiste mitralozit të rëndë të tipit “Shars”.

Mbi këtë bazë filloi të bëhet kërkimi i armës me të cilën ishte bërë qitja vdekjeprurëse. Nga hetimi i mëtejshëm rezultoi se në datën e ndodhjes së vdekjes së fëmijës, në atë zonë ishte zhvilluar stërvitje ushtarake dhe qitje me mitraloz “Shars” në fshatin R. Largësia në mes dy fshatrave në një vijë të drejtë ajrore, sipas hartës topografike ishte 4875m, ndërsa relievi ishte mjaft i thyer, kurse dy fshatrat nuk e shikonin njëri-tjetrin. Me gjithë disa mospërputhje që paraqiste ky rast në fillim, për lidhjen e qitjes së bërë në R., me vdekjen e ndodhur në B., u pranua version mbi mundësinë e shkaktimit të kësaj vdekjeje me mitralozin e përdorur në fshatin R.

Në favor të këtij versioni interpretohet fakti se mitralozat e këtij tipi në këndin e qitjes prej 45° , plumbi mund të fluturoj deri më 5000m. Për të saktësuar versionin e ngritur dhe për të verifikuar mundësinë e vrasjes nga kjo distancë, u zhvilluar qitja eksperimentale. Nga ekzaminimi kriminalistik rezultoi se me të vërtetë predha e gjetur në kokën e viktimës ishte krisur nga ky mitraloz. Për sqarim të mëtejshëm të rrethanave të rastit, u studiua vendi ku është bërë qitja dhe drejtimi qitjes. Qitja ishte zhvilluar në këndin 45° (këndi maksimal i hedhjes së predhës nga një armë) dhe drejtimi qitjes përputhej me pozitën e fshatit ku gjeti vdekjen viktimë. Në fshatin B, dy nga nxënësit që ditën e ngjarjes kishin radhën e pastrimit në shkollë, dëshmuan se kishin dëgjuar zhurma në çatinë e shkollës, që kishin menduar se janë gurë që hidheshin nga nxënësit që luanin jashtë. Thëniet e tyre e provuan me këqyrjen që u bë mbi çati ku u gjetën predha tjera të mbetura nga dita e qitjes.

1.1. Klasifikimi i versioneve

Formimi i versioneve është faza e domosdoshme në procesin e të provuarit. Por duhet pasur parasysh se çdo version e ka edhe kundërversionin e vet. Por, sidoqoftë versionet nuk mund të mbështeten në rrethana të zhveshura nga faktet.

Versionet mund të klasifikohen sipas periudhës kohore se kur ngrihen, kështu dallojmë versionet operative dhe ato hetimore. Versionet operative janë versionet që ngrihen gjatë procedurave operative, paraprake apo procedurave policore. Kurse versionet hetimore janë ato versione që ngrihen pasi që fillojnë hetimet. Sigurisht që versionet operative që ngrihen në fillim të çështjes penale mbështeten në materialin operativ dhe janë më të zbehta, kurse versionet hetimore janë më të sigurta dhe më të qëndrueshme, pasi ata mbështeten në më shumë prova. Po ashtu versionet klasifikohen në: *versione të përgjithshme*, *versione të veçanta* dhe *versione mbi kryerësin e veprës penale dhe provat*.

Versionet e përgjithshme ngrihen atëherë kur hetuesi nuk është i sigurt se ekziston vepra penale apo jo. Pra këto versione kanë të bëjnë me ngjarjen penale në tërësi për të vërtetuar, ekzistencën apo mosekzistencën e veprës penale. Por në realitet versionet e përgjithshme ngrihen shumë rrallë, sepse vet pasoja që është manifestuar në botën e jashtme bën të qartë ekzistencën e veprës penale.

Versionet e veçanta ngrihen pasi që hetuesi vërteton se ekziston vepra penale, bën definimin ligjor dhe pastaj mundohet të sqarojë çdo veprim të kryerësit se si është kryer vepra penale. Pra me versionet e

veçanta hollësisht sqarohet, çdo veprim i kryerësit, ngrihet një pasqyrë e qartë mbi mekanizmin e veprimit të kryerësit. Pra me këto versione në veçanti sqarohen të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me veprën penale.

Versionet mbi kryerësin e veprës penale dhe provat. Këto versione ngrihen atëherë kur hetuesi nuk e ka zbuluar se kush është autori i veprës penale. Bazat për ngritjen e këtyre versioneve, mund të jenë të dhënat që merren nga këqyrja në vendin e ngjarjes si p.sh: provat materiale, gjurmë gishtash, mënyra e kryerjes së veprës penale (modus operandi), dhe të dhëna të tjera për autorin e veprës penale. (zëri, ecja, gjatësia e trupit etj.).

Në kriminalistikë ekzistojnë edhe disa ndarje të tjera. Kështu versionet mund të klasifikohen sipas organit që i ngrit, në këtë rast dallojmë versionet që i ngrit organi hetues dhe versioni i mbrojtjes. Pastaj versionet mund të klasifikohen edhe sipas shkallës së probabilitetit, sipas këtij kriteri ato ndahen në më pak të mundshme, të besueshme, dhe shumë të besueshme. Sipas kohës versionet mund të jenë retrospektive (për të kaluarën) dhe prognozuese. Ekzistojnë edhe ndarje të tjera, varësisht prej autorëve të kriminalistikës.

1.2. Ngritja dhe verifikimi i versioneve

Të dhënat fillestare që kanë shërbyer si bazë për fillimin e çështjes penale dhe për planifikimin e hetimit, shpesh nuk janë të mjaftueshme për të sqaruar të gjitha elementet e veprës penale që ka ndodhur.

Prandaj versionet duhet të jenë të bazuara dhe të mbështetura në prova. Kështu versionet më së shumti ngrihen mbi :

- provat materiale - sende që kanë mbetur në vendin e ngjarjes apo sendet që janë zbuluar gjatë kontrollit të banesës (arma, sendet e vjedhura etj.;

- provat personale – thëniet e qytetarëve, që kanë të bëjnë me kryerësin (lartësia e trupit, mënyra e ecjes, shenja të veçanta në fytyrë, defekte trupore etj.;

- modus operandi– mënyrën e veprimit të kryerësit, kur ajo është tipike për një kategori të caktuar personash.

Por ekzistojnë një kategori veprash penale që mund t'i kryejnë vetëm persona të caktuar (p.sh. kriminaliteti kompjuterik), prandaj në këto raste hetuesi duhet të ngritë versione se kush janë personat që kanë njohuri dhe mundësi të kryejnë vepra penale të kësaj natyre. Pastaj

versionet mund të ngrihen edhe për sa i përket anës subjektive, ose personat që kanë motiv të kryejnë veprën penale. Hetimi i anës subjektive nënkupton edhe atë se vepra është kryer me dashje apo nga pakujdesia.

Ajo që hetuesi detyrimisht duhet bërë, është fakti se të gjitha versionet e ngritura duhet verifikuar dhe mbështetur në prova, njëkohësisht duke eliminuar një nga një, të gjitha versionet tjera që janë treguar si jo të sakta, derisa të mbetet e vërteta mbi ngjarjen penale. Për shembull, në rastin kur një grua e moshuar shpallet e humbur, hetuesi duhet të ngritë më tepër versione: se ajo është vrarë nga nusja e djalit në bashkëpunim me dashnorin, për të krijuar kështu takime dhe për të pasur marrëdhënie intime. Në rast se ky version është i drejtë, atëherë logjikisht duhet të ekzistojnë edhe këto rrethana:

- të gjendet gruaja e vrarë dhe të vërtetohen shenja dhune ose prova se është e helmuar;
- të vërtetohen marrëdhëniet intime në mes nuses dhe dashnorit të saj;
- të vërtetohen fërkimet dhe grindjet në mes nuses dhe vjehrrës, deri në atë shkallë sa që lind nevoja e zhdukjes së saj.⁴

Në rast se ky version është i drejtë, atëherë edhe rrethanat mbi të cilën është ngritur version do të vërtetohen, e nëse vjehrra është rrëzuar dhe ka vdekur ndryshe, atëherë edhe rrethanat nuk do të vërtetohen. Mirëpo ka raste kur version mund të jetë i saktë, mirëpo në mungesë të provave, nuk mund të argumentohet. Prandaj në këto raste edhe pse personi i dyshuar mund të jetë kryerësi i vërtetë, ai do të mbetet në liri, deri sa të sigurohen provat që fajësojnë atë. Por jo rrallë këto prova mund edhe asnjëherë të mos zbulohen, sepse kryerësi është kujdesur për shkatërrimin e tyre. Verifikimi i versionit nënkupton kalimin nga një gjendje e besueshme në një gjendje reale. Është e pamundur që njëkohësisht të ekzistojnë dy versione të kundërta dhe të dyja të jenë të sakta, sepse e vërteta mund të jetë vetëm një dhe assesi ndryshe. Mirëpo shpeshherë versionet, madje edhe ato hetimore, ngrihen vetëm mbi materiale të zbehta dhe intuitën e hetuesit.⁵ Nëse hetuesi ka ngritur drejt

⁴ Latifi, V., (2009), *Kriminalistika*, Prishtinë, fq.77.

⁵ Intuita është një metodë e zgjidhjes së disa çështjeve me nuhatje, me ndjenjë, e cila zhvillohet në bazë të përvojës së subjektit. Kjo metodë vlinë në shprehje te hetuesit me përvojë të madhe që paraprakisht kanë kaluar shumë situata të ngjashme dhe tani në bazë të rrethanave konkrete mund të sjellin ndonjë konkluzë apo mund të ngrenë ndonjë version i cili në fund mund të tregohet si përmbajtësor.

versionin, atëherë edhe hetimet do të marrin kahjen e drejtë, prandaj edhe do të sqarohen rrethanat që kanë të bëjnë me veprën penale.

2. Pyetjet e arta të kriminalistikës

Shkenca e kriminalistikës ka ngritur disa pyetje, të cilave hetuesi duhet t'u japë përgjigje. Vetëm pasi kriminalisti arrin të japë përgjigje në këto pyetje, atëherë çështja mund të trajtohet si e përfunduar në suaza të policisë dhe mund të dërgohet në prokurori.

Pyetjet e arta të kriminalistikës janë të lidhura me anën objektive dhe subjektive të veprës penale dhe autorit të saj.

Pyetjet që kanë të bëjnë me anën objektive janë: çfarë ka ndodhur? (veprën penale, kundërvajtje apo shkelje disiplinore), ku është kryer? (mendohet për vendin e kryerjes dhe çdo vend tjetër ku mund të gjenden gjurmët dhe mjetet e veprës penale), si është kryer? (këtu sqarohen të gjitha episodet e ngjarjes penale, prej fillimit deri në asgjësimin e gjurmëve të veprës penale) dhe me çfarë është kryer? (konstatohet mjeti me të cilët është kryer vepra penale). Kurse pyetjet që kanë të bëjnë me anën subjektive janë: kush është kryerësi? (me cilën është kryer, bashkëkryerësit apo bashkëpunëtorët), pse është kryer? (mendohet në motivin e kryerësit), mbi cilin është kryer? (mendohet në viktimën).

Nga kjo që u tha më lart, mund të vërehet se pyetjet objektive, kryesisht kanë të bëjnë me ndriçimin e veprës penale, ndërsa pyetjet subjektive kanë të bëjnë me ndriçimin e personit që ka kryer veprën penale. Në vijim, për shkak të rëndësisë dhe peshës që kanë pyetjet e arta, do të mundohemi që në mënyrë individuale një nga një të sqarojmë më hollësisht të gjitha.

a. Çfarë ka ndodhur? (vepra penale dhe *corpus delicti*)

Kjo pyetje logjikisht parashtrohet edhe nga të gjithë qytetarët e zakonshëm kur dëgjojnë se ka ndodhur vepra penale. Por edhe çdo fillim i punës operative, fillon me pyetjen se çfarë ka ndodhur. Pra fjala është për pyetjen shumë të rëndësishme e cila imponohet drejtpërdrejt, me të kuptuar për ngjarjen dhe me të cilën mund të vërtetohet ose demantohet dyshimi se është në pyetje vepra penale. Në bazë të rrethanave dhe fakteve të kuptuara, varet se a do të angazhohet hetuesi në rastin konkret apo jo. Gjithashtu lloji dhe karakteri i ngjarjes do të ndikojë në drejtimin e angazhimit të mëtejshëm të personit të autorizuar zyrtar, në detyrat konkrete dhe në rregullat themelore taktike të veprimit.

Një numër i konsiderueshëm i veprave penale, nuk ndiqen sipas parimit *ex officio*, prandaj në këto raste hetuesi do të udhëzoj palën që të bëjë ndjekjen sipas padisë private. Por nëse konstaton se është kryer vepra penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, atëherë personi zyrtar është i detyruar t'i ndërmerr masat e nevojshme me qëllim të zbulimit të kryerësit të veprës penale, të ndërmarrë masat për pengimin e arratisjes apo fshehjes së tij, të sigurojë gjurmët e veprës penale dhe objektet që mund të shërbejnë si provë gjegjësisht të mblidhen të gjitha informatat që do të jenë të dobishme për zhvillimin e procedurës penale. Këtu është shumë e rëndësishme që hetuesi të përcaktojë definimin ligjor të veprës penale.

Kjo pyetje e artë e kriminalistikës na jep po ashtu përgjigje edhe për peshën apo rëndësinë e veprës penale, vallë a bëhet fjalë për vepër të rëndë apo të lehtë penale, në bazë të së cilës edhe do të ndëshkohet kryerësi i saj.

Përveç përcaktimit të veprës penale, hetuesi duhet të ketë të qartë se cilat prova (*corpora delicti*), duhet kërkuar dhe ku ata mund të gjenden.

b. Ku ka ndodhur ? (vendi i ngjarjes – ubi – locus delicti)?

Vendi i ngjarjes së kriminimit ka rëndësi jetike për ndriçimin dhe dokumentimin e veprës penale dhe autorit të saj. Aty mund të gjenden objekte dhe gjurmë që kryerësi i ka lënë pas vetes dhe nuk dinë për ekzistencën e tyre. Pastaj, nëse organi respekton parimin e shpejtësisë dhe befasisë, mund të gjejë edhe dëshmitarët, viktimën, kryerësin etj.

Por vendi i ngjarjes nuk është gjithmonë vendi ku është gjetur kufoma apo është manifestuar pasoja, ky vend mund që të mos përputhet me vendin e vërtetë, i cili qëllimisht është maskuar nga ana e kryerësit me qëllim që hetimet të marrin kahje të gabuar. Prandaj kriminalisti duhet të ketë një qëndrim kritik dhe mirë të analizoj rrethanat që janë në vendin e ngjarjes.

Vend i ngjarjes paraqet hapësirën ku ndërmerren një varg masash dhe aktivitetesh kriminalistike, taktike dhe kriminalistike teknike. Në kuadër të përpunimit kriminalistik të vendit të ngjarjes ndërmerren shumë veprime në bazë të të cilave mund të vijmë deri te indiciet apo dëshmitë e rëndësishme për fillimin dhe përfundimin e procedurës penale. Përmbajtja e përgjigjes në pyetjen ku ka ndodhur vepra penale, ka rëndësi shumë të madhe edhe për faktin që, këtu ka të bëjë me

kompetencën e gjykatës dhe prokurorit të bazuar në faktin se në territorin e tyre është kryer apo është tentuar vepra penale.

c. Kur ka ndodhur? (koha – quando – tempus delicti)

Konstatimi i kohës së saktë apo të përafërt se kur është kryer vepra penale është me peshë të madhe në kriminalistikë. Me kohën ndërlidhen një varg rrethanash që lidhen për kohën e ndërmarrjes së aktit të veprës penale. Gjithmonë në praktikë, një nga çështjet e para që duhet të ndriçohet është Alibi. Të vërtetohet se ku ka qenë i dyshuari në kohën kur është kryer vepra penale.

Koha e kryerjes të disa vepra penale është element i MOS. Përgjigja në këtë pyetje i përket edhe zbatimit të ligjit penal, sepse sjelljet konkrete kriminale të njerëzve grupohen në dispozitat e këtij ligji penal i cili i ka ndërlidhur ato me kohën e ndërmarrjes së tyre.

Konstatimi i kohës së saktë të aktit kriminal, është me rëndësi edhe për shkak se në rastin e analizave të kushteve për zbatimin e normës juridike, merret parasysh koha e kryerjes. Kështu mund të ndodhë që pas kalimit të një periudhe të gjatë kohore, ligji të ndalojë zhvillimin e hetimeve kundër të dyshuarit.

Po ashtu periudha kohore kur është kryer vepra penale, me rastin e konstatimit të moshës së kryerësit, përgjegjësisë së tij, është me rëndësi, sepse dihet se fëmijët e moshës më pak se 14 vjeç, nuk hynë në fushën e ndjekjes penale.

d. Si ka ndodhur? (mënyra – quomodo – modus operandi)

Nuk ka vepër penale që kryhet në mënyrë të njëjtë, secila dallon nga tjetra, prandaj është shumë e rëndësishme që hetuesi të ndriçojë mënyrën se si është kryer vepra penale. Me fjalë tjera, këtu hetuesi duhet të sqarojë episodet se si ka vepruar kryerësi dhe pastaj të sqarojë tërë mekanizmin e kryerjes së veprës penale, që në kriminalistikë njihet si *modus operandi sistem*.

Çdo stacion policor regjistron mënyrën se si ka vepruar kryerësi, dhe në bazë të këtyre të dhënave ngrihen evidencat që njihen si evidencat MOS.

Vërtet këto evidenca në praktikë u ndihmojnë hetuesve shumë që të përcaktojnë rrethin e personave të dyshuar të mundshëm, vetëm në bazë të mënyrës së si është kryer vepra penale.

Dihet se çdo person ka mënyrën e vetë e veprimit, ashtu edhe kriminelët, kur kryejnë vepra penale, ata manifestojnë specifika dhe

karakteristikat e tyre të veprimit që i dallojnë nga të tjerët. Prandaj duke analizuar mënyrën se si ka vepruar kryerësi, përafërsisht mund të përcaktohet i dyshuari.⁶

e. Me çka është kryer? (quibus – auxiliis – instrumenta sceleris)

Sigurisht që mjetet me të cilat kryhen veprat penale janë të panumërta. Por në të gjitha rastet e rënda, si zakonisht kryerësi gjatë kohë mendon cilin mjet ta përdor për të kryer veprën penale, që sipas bindjes së tij do të ishte më i përshtatshëm dhe më efikas. Përveç kësaj, kryerësi edhe më shumë mendon lidhur me vendin se ku do ta fsheh mjetin e përdorur sepse është i vetëdijshëm se po të zbulohet mjeti me të cilën është kryer vepra penale, atëherë kjo do të ishte një provë e fortë kundër tij.

Nga ana tjetër hetuesi, që në fillim të çështjes penale, domosdo duhet të japë përgjigje lidhur me mjetin që ka shërbyer për të kryer veprën penale (pistoleta, kalibri, modeli etj). Pas kësaj, një nga veprimet më të rëndësishme të hetuesit është të zbulojë vendin se ku është fshehur mjeti me të cilën është kryer vepra. Kjo në kriminalistikë njihet edhe si *instrument operandi sistem*. Hetuesi e ka të qartë se mjeti me të cilën është kryer vepra penale, është një nga provat më të fuqishme nga të gjithë provat tjera (*corpora delicti*), sepse në këtë mënyrë sqaron kauzalitetin në mes shkakut dhe pasojës. Mirëpo, ndonjëherë në praktikë, sidomos te veprat penale të paplanifikuara, përdoren mjete të rastit, çfarë i ka ardhur për dore kryerësit (gur, shat, drapër etj), atëherë si zakonisht mjeti gjendet në vendin e ngjarjes.

Pastaj nga mjeti me të cilën është kryer vepra, mund të mësohet shumë mbi cilësitë dhe shkathësitë e autorit, (përdorimi i sëpatës, thikës me mjeshtri) tregon mbi profesionin e kryesit që mund të përdoret si indicie e fuqishme gjatë zhvillimit të hetimeve. Pastaj dihet se tek mjeti i përdorur, mbeten gjurmët e kryerësit (gjurmët e gishtave, djersës, gjakut etj) që mundësojnë identifikimin e shpejtë të tij. Po ashtu hetuesi duhet të vërtetojë nëse mjeti që është përdorur është apo jo i përshtatshëm për kryerjen e veprës penale. Nëse vepra penale ka mbetur në tentative, atëherë duhet të vërtetohet se a janë përdorur mjetet e

⁶ Në Tetovë, ekzistojnë disa raste të vjedhjeve që janë zbardhur me ndihmën e MOS Evidencave, p.sh: Një numër i madh i vjedhjeve janë kryer në mënyrë të njëjtë, kryerësi ka thyer xhamin e madh për të vjedhur sende ushqimore. Te të gjitha rastet tjera ku është thyer xhami dhe janë vjedhur sende ushqimore është ngritur versioni se kryerësi i mundshëm është personi M.N i cili pas bisedave i ka pranuar veprat penale.

përshtatshme për kryerje. Për shkak se nëse kryerësi ka përdorur mjete të papërshtatshme, atëherë mund të dënohet më lehtë.⁷ Kështu kryerësi mund të kanoset me pistoletë që është me defekt ose i plastikës, kuptohet që kjo nuk e përjashton fajësinë e tij, por mund të shërbej si rrethanë lehtësuese, gjatë matjes së dënimit. Hetuesi po ashtu duhet të ketë parasysh dhe të zbulojë edhe personat që në rastin konkret i kanë ndihmuar kryerësit të furnizohet ose të sigurojë mjetin p.sh: i ka dhënë në dispozicion mjetet e kryerjes, (pistoletë, pushkë) ose më vonë, pasi që ka kryer veprën i kanë ndihmuar që ta fsheh mjetin.

f. Me cilin është kryer? (bashkëkryerës ose bashkëpunëtor)

Një numër i konsiderueshëm i veprave penale, nuk mund të kryhen nga një person apo kryerja e tyre kërkon angazhimin e më shumë personave. Me fjalë tjera, hetuesi këtu duhet sqaruar se vepra penale është kryer nga një person apo më shumë persona, duke definuar saktë numrin e tyre.

Në praktikë, jo rrallë herë ndodh që nga vetë-këqyrja e vendit të ngjarjes (nga gjurmët e këmbëve, plagët e shkaktuara, mashtrimi, rekonstrukcioni tek vjedhjet, krimi i organizuar, terrorizmi) të konstatohet se vepra penale është kryer nga pjesëmarrja e më shumë personave. Vetë fakti që në kryerjen e veprës penale kanë marrë pjesë më shumë persona, vepra bëhet më e rrezikshme dhe merret si rrethanë kualifikuese (p.sh. dhunimi nga më shumë persona, nuk është i njëjtë si dhunimi nga një person ose rastet kur vjedhja kryhet me pjesëmarrjen e më shumë personave, që automatikisht bën që vjedhja të jetë e rëndë). Prandaj, shumë e rëndësishme është të zbardhet pjesëmarrja dhe roli i çdonjërit, sidomos kur është fjala për krimin e organizuar.

h. Përse është kryer? (motivi - cur)

Këtu qartë shihet se kërkohet të zbardhohet motivi i veprës penale. Vërtet një numër i madh i autorëve të veprave penale, zbardhohen pikërisht duke ndriçuar motivin e veprës penale apo duke dhënë përgjigje në pyetjet se kush nga personat ka pasur motiv që të kryejë veprën penale (p.sh vrasja mizore, goditja dhe shkaktimi i plagëve të shumta në trup, tregon hakmarrjen e kryerësit dhe mllefin e madh që kishte kundër tij.)

⁷

Korajlić, N. & Muharemi, D., (2009), *Kriminalistika*, Prishtinë, f.115.

Në bazë të motivit, hetuesi eliminon personat që nuk kanë pasur motiv të kryejnë veprën penale dhe kështu ngushton rrethin e personave të dyshimtë të cilët në rastin konkret nuk kanë pasur motiv për të kryer veprën penale.

g. Ndaj kujt është kryer? (viktima)

Në praktikë një numër i madh i veprave penale, pikërisht paraqiten nga vet i dëmtuari, me çka organi mëson se ndaj kujt është kryer vepra penale. Këto janë ato vepra penale, ku është prekur interesi i të dëmtuarit. Në këto raste hetuesi gjatë bisedave me të dëmtuarin si dhe gjatë ndriçimit të veprës penale në përgjithësi, duhet të verifikoj edhe kontributin e vet personit se sa ka ndikuar me sjelljen e tij që të jetë viktimë.

Ndriçimi i të gjitha rrethanave është i rëndësishëm për nxjerrjen e së vërtetës në sipërfaqe dhe dënimin më të butë të kryerësit i cili në masë të madhe apo të vogël është provokuar nga vet i dëmtuari. Mirëpo ka edhe disa vepra penale të cilat edhe pse kryhet vepra penale dhe dëmtohet personi, për rrethanat të ndryshme, i dëmtuari nuk denoncon rastin në polici. (përdhunimi). Po ashtu ka edhe raste kur nuk mund të përcaktohet identiteti viktimës, kjo për shkak të dëmtimeve të mëdha trupore ose për shkak të procesit të avancuar të kalbëzimit ku nuk mund të përcaktohet identiteti. Në këto raste me ndihmën e metodave të mjekësisë ligjore, mund të identifikohet personi.

j. Kush është kryerësi i veprës? (quis auctor)

Është e kuptueshme se në fund duhet të japim përgjigje se kush është kryerësi. Kësaj pyetje nuk është e lehtë në praktikë që menjëherë pas ngjarjes t'i jepet përgjigje, prandaj në të shumtën e rasteve përgjigja jepet në fund, pas mbarimit të hetimeve policore. E gjithë filozofia e hetimeve zhvillohet pikërisht që t'i jepet përgjigje kësaj pyetje se, kush është autori i veprës penale?. Prandaj edhe merren të gjitha veprimet operative dhe hetimore që të zbulohet kryerësi dhe të sigurohen prova për fajësinë e tij.

Ekzistojnë disa vepra penale, për të cilat që në momentin e kryerjes, menjëherë mund të jepet përgjigje se kush është kryerësi. Këto janë ata vepra penale që mund të kryhen vetëm nga personat e caktuar (delicta propria). Prandaj në rastin kur zbulohet vepra penale, menjëherë zbulohet edhe kryerësi. p.sh: vrasja e foshnjës gjatë lindjes, autor mund të jetë vetëm nëna ose bastisjet e kundërligjshme, mund t'i bëjë

vetëm personi zyrtar, mjekimin e pandërgjegjshëm e ushtron vetëm mjeku etj. Por në ndriçimin e veprave penale, në të shumtën e rasteve, hetuesi arrin të japë përgjigje mbi autorin në fund të hetimeve, pasi ka grumbulluar shumë prova lidhur me dyshimin e bazuar, andej jo rrallë edhe asnjëherë nuk i jepet përgjigje kësaj pyetje sepse kryerësi kur nuk zbulohet.⁸

Conclusion

In our country, the investigations are conducted with great difficultiess; the investigator has to be aware that no one will help him; people that have witnessed the case leave quickly, or flee the scene in order to not be summoned in the quality of a witness, but even when they are summoned, they refuse to give a statement, with the excuse that they have not seen anything from the penal case and that they don't know who is the perpetrator. The truth is, each person called as a witness, experiences a bad sensation, be it because of the threatenings from the perpetrator, or due to the gnawing conscience, to not be the person who causes someone to end up in jail for many years. All these circumstances make the process of investigation too complicated and difficult.

Therefore it is good for the investigators to direct their attention towards physical proofs or material proofs, and based on them to raise interpretations. In these cases, the interpretations are intact and supported by real arguments, while in front of material proofs everyone has to relent.

Bibliografia

- Abadinsky, H., (1994), *Organized Crime*, Chicago.
- Alison, C., (1973), *Personal Identification*, Boston.
- Adams, T.F., (2004), *Crime scene invastigation*, Prentice Hall, Upper Saddle River.
- Aleksić, Ž., (1994), *Kriminalistika*, Beograd.
- Alderson, J., (1995), *Ljudska prava i policija*, Rijeka.
- Ačimović, M., (1978), *Psihologija sudenja i zlocina*, Beograd.

⁸ Nga raporti i MPB lidhur me vëllimin dhe dinamikën e zbulimit të veprave penale dhe autorëve të saj, mund të shihet se brenda dy dekadave (1990-2010), vetëm 20-25% e autorëve janë zbuluar dhe është dhënë përgjigje në pyetjen se kush është autori veprës penale.

- Алексоски С., (2005), *Психологија со криминалистичка психологија*, Shkup.
- Ангелески, М., (2007), *Вовед во криминалистика*, Shkup.
- Ангелески, М., (2007), *Криминалистичка тактика*, Shkup.
- Avziu, Q., (2014), *Justicia, Nr.2*, Tetovw.
- Bayer, V., (1943), *Kazneno Pustopovno Pravo*, Zagreb.
- Bayley, D., (1995), *Police for the Future*, Oxford University Press, New York.
- Barry, A. F.- David, R.F., (2012), *Crime scene invstigation*, Los Angeles.
- Barry, M. B.,(2006), *Becoming a Police Officer*, Shkup.
- Batalli, F., (1987), *Mjeksia Ligjore*, Prishtinë.
- Batolska, L. (2007), *Kriminalistika Psihologija*, Shkup.
- Batkovski, T., (2008), *Taktika na Razuznavanje, Bezbednost i Kontrarazuznavanje*, Shkup.
- Bačić, F., (1995), *Krivicno Pravo*, Zagreb.
- Begeja, S., (2001), *Kriminalistika*, Vëllimi I, II. Tiranë.
- Begeja, S., (1998), *Bazat shkencore të oragnizimit dhe të hetimit të veprave penale*, Tiranë Bajgora, A., (1998), *Krimet kundër lirive dhe të drejtave në Kosov*, Prishtinë.
- Bošković, M., (2000), *Kriminalistika*, Beograd.
- Bošković, M., (1998), *Organizovani Kriminalitet*, Beograd.
- Brandl, S. G., (2004), *Criminal Invastigation-an analytical perspective*, Boston.
- Byrd, m., (2001), *Crime scene evident*, Wildomar.
- Çipi, B., (2011), *Identifikimi i Personit*, Tiranë.
- Damaška, M.,(1962), *Okrivljenikov iskaz kao dokaz u suvremenom krivinom procesu*, Zagreb.
- Demolli, H., (2002), *Terrorizmi*, Prishtinë.
- Doracak i OSBE-së. (2013), *Teknika e zhvillimit të intervistës me të dyshuarin*, Shkup.
- Dimitrijevic, V., (1985), *Strahovlada*, Beograd.
- Dimitrov, D., (1995), *Policiski Informatori*, Shkup.
- Dragoti, E., (1999), *Adoleshenti*, Tiranë.
- Elezi, I., (2002) , *E drejta penale*, pjesa e posaçme, Tiranë.
- Elezi, I., (2000), *Vrasjet për hakmarrje e për gjakmarrje në Shqipëri*, Tiranë.